Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

RAPORT VJETOR

RAPORT VJETOR I AUTORITETIT
KOMBËTAR TË KUALIFIKIMEVE PËR VITIN 2022

2022

https://akkks.rks-gov.net/

PËRMBAJTJA

Fjalë hyrëse....5
Misioni....8
Vizioni....9

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve....9

Përbërja e Këshillit drejtues të AKK-së:....12
Korniza ligjore....14
Synimet dhe objektivat....14
Akterët e rëndësishëm....15

Planifikimi dhe plani i punës 2022....16
Raporti i aktiviteteve për vitin 2022....18

Implementimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK)....18
Verifikimi i standardeve të profesionit....19
Validimi dhe aprovimi i kualifikimeve në KKK dhe akreditimi i ofruesve të AAP....22
Njohja e Mësimit Paraprak (NjMP)....33
Sektori i sigurimit të cilësisë....34
Sektori i Monitorimit të IAAP pas akreditimit....36
Promovimi i KKK....43
Takimet me palët e interesit....44
Organizimi i punëtorive dhe seminareve....44
Botimi dhe shpërndarja e publikimeve dhe materialeve promovuese....47
Mirëmbajtja dhe përditësimi i uebfaqes....48
Mbështetja dhe bashkëpunimi ndërkombëtar....48

Fjalë hyrëse



Në harmoni me misionin, vizionin dhe planifikimin e tij vjetor, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK), gjatë vitit 2022 ka realizuar një gamë të gjerë të aktiviteteve.

Si përherë, synimi parësor i AKK mbetet sigurimi i cilësisë në Arsimin dhe Aftësimin Profesional (AAP). Bazuar në këtë edhe gjatë këtij viti jemi angazhuar dhe kemi ofruar mundësi dhe përkrahje për të gjithë ofruesit/institucionet me qëllim që t`i kontribuojmë ngritjes së cilësisë e rrjedhimisht paisjes së nxënësve/kandidatëve me shkathtësitë e kërkuara në tregun e punës.

Si organ i pavarur publik, që vepron në marrrëveshje me Qeverinë, AKK është kujdesur që të punoj në harmoni me frymën dhe kërkesat e dala nga Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021 – 2025. Një nga prioritetet e Qeverisë së Kosovës për sektorin e arsimit, të prezantuara në Program është arsimi dhe aftësimit profesional. Vëmendja kryesore është përqendruar në harmonizimin e arsimit dhe aftësimit profesional me kërkesat e tregut të punës. Në këtë rrafsh AKK është angazhuar të jep kontributin e vet brenda obligimeve dhe detyrave të përcaktuara me ligj.

Të vetëdijshëm për rolin dhe përgjegjësinë që i takon, stafi i AKK ka punuar me përkushtim në realizimin e objektivave dhe detyrave të paracaktuar. Me gjithë sfidat e ndryshme që kanë përshkuar veprimtarinë e tij si, numër i kufizuar i stafit, hapësirat e pamjaftueshme të punës, përfundimi i mandatit të Këshillit Drejtues (KD) në muajin shtator, emërimi i zëvendësdrejtorit etj., AKK edhe këtë vit ka arritur që të ketë rezultate të theksuara. Gjatë vitit 2022 janë aprovuar 3 Standarde të Profesionit (SP) në nivel kombëtar, ndërsa për 26 standarde te profesionit presin shqyrtimin e tyre nga KD të AKK-së. Është zhvilluar procesi i validimit të kualifikimit dhe akreditimit për 50 institucione/ofrues, ku nga ky numër 49 insitucione kanë arritur të marrin akreditimin me 88 kualifikime të validuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve.

Po ashtu, KD i AKK deri në përfundim të mandatit të tij ka aprovuar 40 kërkesa të ofruesve/ institucioneve për hyrje në procesin e akreditimit si dhe 81 kualifikime.

AKK gjatë këtyre 12 muajve ka realizuar edhe aktivitete të shumta këshillëdhënëse dhe ka ofruar informata kthyese profesionale, për proceset e akreditimit. Ka pranuar raporte të vetëvlerësimit nga institucione të ndryshme dhe ka dhënë informata kthyese për përformancën e ofruesve të arsimit dhe aftësimit profesional, si dhe për treguesit sipas Kornizës Kombëtare të Sigurimit të Cilësisë (KKSC). Stafi i AKK është angazhuar edhe në monitorimin e drejtpërdrejtë dhe në distancë të institucioneve të arsimit dhe aftësimit professional, pas akreditimit të tyre.

Në këtë vit AKK po ashtu ka organizuar hulumtimin me palët e interesit rreth ndikimit të KKSC-së për zbatimin e sigurimit të cilësisë në AAP. Kjo ka shërbyer pastaj në përmbylljen me sukses të procesit të rishikimit dhe plotësimit të dokumentit të KKSC-së.

Një rezultat tjetër që duhet theksuar është dhe zhvillimi dhe vënja në fuqi nëpërmjet KD të AKK i Rregullores Nr.01/225 për caktimin dhe vazhdimin e vlefshmërisë së afateve të standardeve kombëtare të profesionit, përmes të cilës përcaktohet dhe rregullohet aspekti procedural për caktimin si dhe vazhdimin e afatit të SP-ve.

Gjithashtu duhet përmendur se KD i AKK këtë vit ka shqyrtuar dhe aprovuar listën e ekspertëve të jashtëm për proceset e validimit të kualifikimeve dhe akreditimin e institucioneve, verifikimin e standardeve të profesionit dhe zbatimin e Njohjes së Mësimit Paraprak (NjMP).

Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë ka qenë njëra nga angazhimet tona të suksesshme gjatë këtij viti. Në harmoni me përkushtimet tona shtetrore për integrimet evropiane e veçanërisht me tregun evropian të punës, jemi angazhuar që të kemi bashkëpunim, ndërveprim e koordinim me institucionet dhe rrjetet evropiane.

Në këtë frymë përfaqësues të AKK-së kanë marrë pjesë në takime e konferenca ndërkombëtare ku janë trajtuar tema për: aspekte të sigurimit të cilësisë, menaxhimin e të dhënave dhe politikbërjen, rëndësinë e komunikimit rreth përfitimeve të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve dhe Kornizave Kombëtare të Kualifikimeveve, promovim e Kornizave Kombëtare të Kualifikimeve, shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira në sistemin e AAP etj.

Përkrahja e institucioneve ndërkombëtare si ai i Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë ka qenë i padiskutueshëm dhe për këtë i shprehim respektin dhe falenderimin tonë. Gjithashtu, për përkrahjen dhe bashkëpunimin e përhershme duam të falenderojmë edhe Fondacionin Evropian për Trajnim (ETF) si dhe të gjithë partnerëve tjerë zhvillimorë të cilët e kanë mbështetur AKK-në drejt përmbushjes së misionit dhe vizionit të tij.

Falënderime i dedikojmë edhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, e veçanërisht ministres, znj. Arbërie Nagavci, për mbështetjen dhe zotimin për përkrahje të mëtejme të AKK-së.

Krejt në fund duam të falënderojmë Këshillin Drejtues dhe stafin e AKK për kontributin e vyer në zhvillimin e institucionit, si dhe performancën e treguar gjatë vitit 2022.

Arbër Salihu, Zv. i drejtorit të AKK


Misioni

Misioni i AKK-së, është të mbikëqyrë dhe të zhvillojë Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve në kontekst të të mësuarit gjatë gjithë jetës, në partneritet me nxënësin/kandidatin, punëdhënësin dhe ofruesit e arsimit dhe aftësimit në të gjitha nivelet dhe në përputhje me nevojat dhe kërkesat e shoqërisë dhe ekonomisë.



Vizioni

Vizioni i AKK është krijimi i një sistemi cilësor, të besueshëm dhe transparent të kualifikimeve kombëtare, me qëllim të rritjes së mundësive për zhvillim, punësim, progres dhe mobilitet për të certifikuarit në kualifikimet e KKK.



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK), është organ i pavarur publik, i themeluar sipas Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikime Kombëtare.

Sipas Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikime Kombëtare, AKK është përgjegjëse për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) si dhe rregullon dhënien e kualifikimeve brenda kornizës.

Funksionimi i Autoritetit mbështetet në legjislacionin në fuqi, rregullore, udhëzimet administrative, Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), dokumente politikash dhe udhëzues të ndryshëm.

Sipas ligjit të lartcekur AKK, ka Këshillin Drejtues prej trembëdhjetë (13) anëtarësh, të aprovuar nga Qeveria e Kosovës, të cilët përfaqësojnë ministritë dhe partnerët social si dhe universitetet. Këshilli drejtues i AKK, takohet së paku gjashtë (6) herë në vit.

Për realizimin e funksioneve dhe obligimeve, punëve dhe detyrave në AKK janë të punësuar gjithsej dhjetë zyrtarë.
AKK ka përgjegjësi përcaktimin e niveleve të kualifikimeve në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve, ndërlidhjen dhe harmonizimin me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve(KEK), verifikimin dhe aprovimin e standardeve të profesionit, përcaktimin e kritereve për aprovimin e kualifikimeve dhe akreditimin e institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional (AAP), përfshirjen e kualifikimeve të aprovuara në KKK, lehtësimin e progresit dhe transferit, njohjen e mësimit paraprak (NjMP), sigurimin e jashtëm të cilësisë, si dhe monitorimin e institucioneve të akredituara të AAP.

Sistemi i arsimit dhe aftësimit profesional (AAP), si dhe ai i arsimit të lartë (AL) në Kosovë, duhet t'i plotësojë në mënyrë të përshtatshme nevojat e ekonomisë së tregut. Ngritja e cilësisë në sistemin e arsimit dhe aftësimit profesional dhe arsimit të lartë, është prioritet i Qeverisë së Kosovës dhe shoqërisë sonë, në mënyrë që shkathtësitë profesionale dhe kompetencat e individëve që përfundojnë AAP dhe AL, të jenë në nivel të kënaqshëm. Përkundër progresit të arritur deri më tani, mbetet ende sfidë për të gjithë akterët relevant në Republikën e Kosovës që të krijojnë fuqi punëtore të aftë, fleksibile dhe konkurrent në tregun vendor, rajonal e më gjerë.

Prandaj, një ndër kriteret kryesore që duhet të plotësojnë kualifikimet për tu aprovuar dhe vendosur në KKK është përputhja e këtyre kualifikimeve me kërkesat e tregut të punës. Ky është ndikimi i drejtpërdrejt i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve në ekonominë tonë. Korniza me kriteret e saj parasheh që institucionet, të cilat dëshirojnë të zhvillojnë një kualifi- kim, duhet të paraqesin dëshmi se kualifikimi kërkohet në tregun e punës. Si dëshmi mund të përdoren hulumtimet e tregut të punës, konsultimet, rekomandimet e institucioneve qeveritare që zhvillojnë politika zhvillimore si MASHT, MPMS, OEK, KAAPRr, etj. Gjithashtu, sipas KKK, kualifikimet e zhvilluara duhet të bazohen në standarde të profesionit, të cilat janë bazë për ta arritur këtë.

Standardet e profesionit duhet të zhvillohen drejtpërdrejt bazuar në kërkesat e profesionit të caktuar në vendin e punës. Punëdhënësi merr pjesë aktive në këtë proces dhe paraqet kërkesat e nevojshme, të cilat punëtori duhet t'i demonstrojë për kualifikimin në fjalë. Kjo është një ndër kriteret e KKK që duhet të plotësohet nga institucionet, të cilat zhvillojnë kualifikime. AKK ka zhvilluar dhe hartuar udhëzues të shumtë, të cilët ndihmojnë institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional t'i përmbushin kriteret që kualifikimet e tyre të jenë pjesë e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.

Përbërja e Këshillit drejtues të AKK-së:

Agron Bajraktari [1]	Kryetar, Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (USHA - Ferizaj)
Arian Zeka [2]	Nënkryetar, Oda Ekonomike Amerikane (OEA)
Enver Hajrullahu [3]	Anëtar, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI)
Hysen Bytyqi	Anëtar, Universiteti i Prishtinës (UP)
Bekim Hasanaj	Anëtar, Don Bosko
Vjollca Gërvalla	Anëtare, Agjencioni i përkrahjes së punësimit Kosovë (APPK)
Mehreme Llumnica	Anëtare, (HENDIKOS)
Fisnik Lakna	Anëtar, Agjencia e Akreditimit të Kosovës (MPMS)
Besim Mustafa	Anëtar, Oda Ekonomike e Kosovës (OEK)
Fatlinda Gashi	Anëtare, Ministria e Financave (MF)
Majlinda Rizvanolli Bajraktari	Anëtare, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASHTI)
Bekim Fusha [4]	Anëtar, Ministria e Shëndetësisë (MSh)
Ryve Prekorogja	Anëtare, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASHTI)

Bazuar në vendimin Nr.17/64, të datës 11.09.2018, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, mandati i anëtarëve të KD të AKK është 4 vjecar, dhe se i njejti ka skaduar me datë 11.09.2022.

[1] Deri me datë 31.03.2022 ka qenë anëtar i KD së AKK.
[2] Deri me datë 17.06.2022 ka qenë anëtar i KD së AKK
[3] Deri me datë 11.01.2022 ka qenë anëtar i KD së AKK
[4] Deri me datë 22.02.2022 ka qenë anëtar i KD së AKK



Takim i Këshillit Drejtues të AKK

Stafi I AKK:

Arbër Salihu	Zv. i drejtorit të AKK
Avni Gashi	U.D. i drejtorit të AKK
Bleta Kadriu	Eksperte për standarde
Milot Hasangjekaj	Ekspert për kualifikime
Kaltrina Mulliqi	Eksperte për sigurim të cilësisë
Anitë Rukovci	Zyrtare e lartë për monitorim të institucioneve
Donjeta Nimani	Zyrtare e lartë për njohjen e mësimit paraprak
Pakize Isufaj	Zyrtare e lartë për financa
Hysni Mustafa	Zyrtar i lartë ligjor
Vilzan Arifaj	Zyrtar i lartë për Teknologji informative dhe Logjistikë
Donjeta Gashi	Asistente administrative

[5] Nga data 21.11.2022 Arbër Salihu me vendim të Ministres u emërua Zv. i drejtorit të AKK
[6] Deri me datë 21.11.2022 Avni Gashi ka ushtruar detyrën si U.D. i drejtorit të AKK

Korniza ligjore

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, kryen funksionet dhe përgjegjësitë në pajtim me:

- Ligjin nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare;
- Ligji nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional;
- Ligji nr. 04/L-143 për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur në Republikën e Kosovës;
- Rregullorja nr.01/196 për Punën e Këshillit drejtues të Autoritetit Kombëtar te Kualifikimeve;
- Rregullorja nr.01/521 për Përcaktimin e Procedurave për Aplikimin e Institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP) për Akreditim Institucional, Validim dhe Aprovim të Kualifikimeve sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), dhe për Aplikim të Institucioneve që Zbatojnë Njohjen e Mësimit Paraprak (NjMP);
- Udhëzimi administrativ (MASHT) nr.09/2019 për Kriteret dhe Procedurat për Akreditimin e Institucioneve që e Zbatojnë Njohjen e Mësimit Paraprak në Kosovë;
- Udhëzimi administrativ (MASHT) nr.35/2014 për Kriteret dhe Procedurat për Validimin dhe Aprovimin e Kualifikimeve Kombëtare dhe Akreditimin e Institucioneve qe Ofrojnë Kualifikime në Kosovë;
- Udhëzimi administrativ (MASHT) nr.32/2014 për Kriteret dhe Procedurat për Sigurimin e Cilësisë në Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional – Proceset e Brendshme;
- Udhëzimi administrativ (MASHT) nr.31/2014 për Njohjen e Mësimit Paraprak;
- Udhëzimi administrativ (MASHT) nr.28/2014, për Kriteret dhe Procedurat për Verifikimin e Standardit të Profesionit.

Synimet dhe objektivat

Ndër synimet parësore të AKK është implementimi dhe përditësimi i sistemit Kombëtar të Kualifikimeve (KKK) në kontekst të të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe në partneritet me kandidatë, punëdhënës dhe institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional (IAAP) në përputhshmëri me nevojat dhe kërkesat e shoqërisë dhe ekonomisë.

Për ta arritur këtë, AKK:

• përcakton kriteret dhe aprovon kualifikimet që përfshihen në nivelet e caktuara të KKK;
• përcakton kriteret dhe akreditон, rregullon dhe monitoron institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional (IAAP);
• mirëmban bazën e të dhënave të kualifikimeve në KKK dhe certifikatave e diplomave të dhëna;
• bën rishikime periodike të vlerësimit, si dhe krahasime ndërkombëtare të kualifikimeve;
• bën këshillimin e institucioneve përgjegjëse për njohjen e kualifikimeve të huaja, për qëllime akademike/profesionale ose punësimi, përkitazi me çështjet e krahasueshmërisë dhe barasvlerës;
• miraton dhe vulos certifikatat, diplomat për kualifikimet në KKK duke përfshirë titullin e aprovuar të kualifikimit, nivelin e tij në KKK, kreditë, si dhe informata tjera.



Akterët e rëndësishëm

Për të ushtruar funksionet dhe përgjegjësitë e veta, AKK krijon, zhvillon dhe mirëmban raporte bashkëpunimi dhe konsultimi me të gjithë akterët relevant të KKK, përfshirë:

• Nxënësit/kandidatët/studentët;
• Mësimdhënësit, trajnerët dhe instruktorët;
• Institucionet publike dhe private të arsimit dhe aftësimit profesional, kolegje dhe universitete;
• Koordinatorët për sigurimin e cilësisë;
• Punëdhënësit dhe të punësuarit;
• Sindikata dhe shoqata profesionale;
• Agjencitë relevante dhe Këshillat profesionale;
• Qeverinë qendrore dhe lokale, etj.

Planifikimi dhe plani i punës 2022

Objektivat themelore të AKK-së për vitin 2022, bazohen në Ligjin për Kualifikimet Kombëtare (Nr.03/L-060) dhe legjislacionit sekondar, që përcakton AKK përgjegjëse për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).
AKK kujdeset për kornizën gjithëpërfshirëse të kualifikimeve dhe rregullon dhënien e kualifikimeve brenda kornizës.
Pas realizimit me sukses të planit dhe obligimeve të përcaktuara për vitin 2022, AKK për vitin pasues, do të vazhdoj të punoj me përkushtim për përmbushjen e obligimeve ligjore dhe objektivave të përcaktuara. AKK do të mbështes të gjitha institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional (IAAP) në Republikën e Kosovës përmes ofrimit të shërbimeve si dhe do të angazhohet që të përmbushë misionin e vet në interes të qytetarëve dhe në linjë më nevojat e tregut të punës dhe zhvillimit ekonomik në vend.

Objektivat dhe aktivitetet që AKK synon t'i realizojë përgjatë vitit 2022 janë:

1. Promovimi dhe zbatimi i KKK në linjë me kërkesat dhe nevojat e sistemit të kualifikimeve në vend dhe Kornizës Europiane të Kualifikimeve (KEK);
2. Verifikimi dhe miratimi i standardeve kombëtare të profesionit (SKP);
3. Validimi dhe ri-validimi i kualifikimeve në KKK dhe akreditimi dhe ri-akreditimi i institucioneve publike dhe private të arsimit dhe aftësimit profesional (IAAP);

4. Akreditimi i institucioneve për Njohjen e Mësimit Paraprak (NjMP);
5. Monitorimi i institucioneve të akredituara, hartimi i aktit nënligjorë për monitorim;
6. Dizajnimi i platformës elektronike të monitorimit të institucioneve pas akreditimit;
7. Bashkëpunimi profesional me institucionet e AAP për sigurimin e cilësisë;
8. Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet partnere për zbatimin e KKK;
9. Promovimi i KKK përmes aktiviteteve me qëllim të informimit të opinionit dhe grupeve të interesit lidhur me strukturen dhe llojet e kualifikimeve, progresin dhe mundësitë.
10. Bashkëpunimi dhe zgjerimi i partneriteteve me institucione vendore e ndërkombëtare duke përfshirë edhe projektet e BE-së dhe organizmave tjerë të rëndësishëm;
11. Zhvillimi profesional dhe rritja e kapaciteteve të AKK-së përmes trajnimeve profesionale.
12. Rekrutimi i stafit profesional dhe mbështetës.
13. Procedimi i Rregullores për Sistematizimin e Vendeve të Punës të AKK.
14. Hartimi i koncept dokumentit për projekt ligjin e AKK;
15. Hartimi i Ligjit të AKK;
16. Rishikimi i akteve nënligjore;
17. Rishikimi i Kornizës Kombëtare të Sigurimit të Cilësisë (KKSC);
18. Zhvillimi i udhëzuesve të ndryshëm të AKK.

Plani i punës për vitin 2022, është publikuar në uebfaqen e AKK: https://akkks.rks- gov.net/akk/raporti-vjetor-i-akk-se

Raporti i aktiviteteve për vitin 2022

Ky raport është një përmbledhje e aktiviteteve dhe objektivave të realizuara të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve gjatë vitit 2022 në përputhje me planin e punës për këtë vit dhe në përputhje me Ligjin për Kualifikimet Kombëtare. Raporti është hartuar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve dhe miratuar nga Këshilli Drejtues i AKK-së.

Raporti i punës është i strukturuar sipas funksioneve të AKK dhe prezenton punët e bëra, rezultatet e arritura dhe sfidat që e kanë përcjellë gjatë periudhës raportuese.

Implementimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK)

KKK është e rregulluar përmes mekanizmave të cilët sistemin e kualifikimeve kombëtare e bëjnë cilësor, të përshtatshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.
Mekanizmat për arritjen e këtyre objektivave janë:

- Verifikimi i standardeve të profesionit;
- Validimi dhe aprovimi i kualifikimeve të propozuara për përfshirje në KKK;
- Akreditimi i institucioneve përgjegjëse për ofrimin, vlerësimin dhe certifikimin e kualifikimeve të miratuara të KKK-së;
- Njohja e mësimit paraprak (NjMP);
- Monitorimi i institucioneve pas akreditimit;
- Promovimi i KKK.

Verifikimi i standardeve të profesionit

Standardet e profesionit (SP) janë njësi për ta matur shkallën deri në të cilën një individ mund t'i përmbushë kërkesat për realizim në një profesion të veçantë ose grup profesionesh, me qëllim që të hyjë ose përparojë në kuadër të një profesioni ose fushe përkatëse profesionale. Standardi i profesionit është pikënisje për zhvillimin e kualifikimit, kurrikulës, programit, kritereve të vlerësimit, rezultateve mësimore, etj.

Standardi i profesionit zhvillohet në bashkëpunim: MASHTI, MPMS, ministritë tjera relevante, partnerët socialë dhe shoqatat e zejtarëve. Standardi i profesionit zhvillohet duke u bazuar në metodat për zhvillimin e tyre si dhe bazuar në kriteret e përcaktuara nga AKK. Standardi i profesionit verifikohet nga AKK sipas legjislacionit në fuqi. Standardi i profesionit i cili kalon në procesin e verifikimit dhe miratohet nga KAAPRr quhet standard kombëtar i profesionit.



Takim gjatë procesit të verifikimit të standardeve të profesionit

Sektori i standardeve gjatë kësaj periudhe ka finalizuar një numër të konsiderueshëm të aktiviteteve lidhur me proceset e verifikimit të standardeve të profesionit si dhe aktivitetet tjera që ndërlidhen me punën e AKK-së.

Gjatë periudhës raportuese janë aprovuar tre SP, si standarde të profesionit në nivel kombëtar (shih tabelen nr. 1) si dhe ka përfunduar procesi i verifikimit për një numër të konsiderueshëm të standardeve të profesionit (shih tabelen nr. 2), të cilat presin shqyrtimin dhe aprovimin nga Këshilli Drejtues i AKK. Poashtu, AKK është duke zhvilluar procesin e verifikimit edhe për një standard të profesionit i cili është në fazën e fillimit për këtë vit.

Për të realizuar proceset e verifikimit të SP janë zhvilluar dhjetëra takime me ekspertët e përzgjedhur (ekipet verifikuese), ku janë dhënë instruksione dhe qartësime tjera lidhur me procesin e verifikimit të standardeve të profesionit. Gjithashtu, janë realizuar edhe takimet me zhvilluesit e SP dhe bizneset e ndryshme në kuadër të realizimit të procesit të verifikimit ashtu sic parashihet me procedurat e AKK.

Kryesisht, një numër më i lartë i standardeve të profesionit janë zhvilluar nga institucione me mbështetjen e projekteve të ndryshme, si MASHTI (mbështetur nga projekti EYE, ALLED 2 dhe LUX Development), AAAPRr (mbështetur nga DVV Internacional), Qendra për Trajnim dhe Çertifikim për Materie të Rrezikshme (QTCE) me mbështetjen e Fakultetit të Gjeoshkencave në Mitrovicë dhe shoqata të tjera.

Nr.	Standardet e profesionit te aprovuar nga KD e AKK	Zhvilluesi i standardit të profesionit
1	Rrobaqepësit, rrobaqepëset, gëzofpunuesit dhe kapelabërësit	AAAPRr/DVV International
2	Gjuajtësit dhe shpërthyesit, niveli IV i KKK	Qendra për Trajnim dhe Çertifikim për Materie të Rrezikshme QTCE/Fakulteti i Gjeoshkencave të Mitrovicë
3	Gjuajtësit dhe shpërthyesit, niveli V i KKK	Qendra për Trajnim dhe Çertifikim për Materie të Rrezikshme QTCE/Fakulteti i Gjeoshkencave të Mitrovicë

Tabela 1. Standardet e profesionit të verifikuara dhe të aprovuara nga KD i AKK gjatë vitit 2022

Në tabelën më poshtë janë të dhënat e standardeve të profesionit të cilat kanë kaluar nëpërmes procesit të verifikimit, por që janë në pritje të miratimit nga Këshilli Drejtues i AKK. Në këtë tabelë janë 26 standarde të profesionit që janë zhvilluar nga MASHTI me mbështetjen e projekteve EYE, ALLED 2 dhe LUX Development, AAAPARr me mbështetje të DVV International dhe Shoqata e artistëve të Tatuazhit.

Nr.	Emri i standardit të profesionit	Zhvilluesi
1	Teknik i operimit me TIK	MASHT/EYE
2	Teknikët e inxhinierisë së telekomunikimit	MASHT/EYE
3	Punëtorët e zejës me tekstil, lekurë dhe materiale të ngjashme	MASHT/EYE
4	Teknikët e bujqësisë	MASHT/EYE
5	Ndërtuesit e shtëpive	MASHT/EYE
6	Punëtorët e kornizave të ndërtimit	MASHT/EYE
7	Shtruesit e dyshemesë dhe punëtorët për vendosjen e pllakave	MASHT/EYE
8	Suvatuesit	MASHT/EYE
9	Ngjyrosësit dhe punëtorët e ngjashëm	MASHT/EYE
10	Mekanikët e kondicionerëve dhe të ftohjes	MASHT/EYE
11	Punëtorët e impantit për gjenerimin e energjisë	MASHT/EYE
12	Prodhuesit e tapicerive dhe të ngjajshme	MASHT/EYE
13	Dizajnerët dhe dekoderët e eneterierit	MASHT/EYE
14	Nëpunës i prodhimit	MASHT/EYE
15	Teknik i Inxhenierisë elektronike	MASHT/ALLED 2
16	Mekanikët dhe riparuesit e automjeteve bujqësore	MASHT/ALLED 2
17	Teknik i Pylltarise	MASHT/ALLED 2
18	Ngjyrosësit me spërkatje dhe Lastruesit me llak	MASHT/ALLED 2
19	Mekanikët dhe montuesit elektrik	MASHT/ALLED 2
20	Kamarierët	MASHT/ALLED 2
21	Mekanikët dhe punëtoret e servisimit të paisjeve elektronike	MASHT/ALLED 2
22	Prodhuesit e produkteve të bylmetit	MASHT/ALLED 2
23	Punetorët e llamarinave	MASHT/ALLED 2
24	Kuzhiner	MASHT/LUX Development
25	Microblading artist/artiste	Shoqata e Artistave të Tatuazhit të Kosovës
26	Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit	AAAPARr/DVV International

Tabela 2. Standardet e profesionit të verifikuara që presin shqyrtim nga Këshilli Drejtues I AKK.

Validimi dhe aprovimi i kualifikimeve në KKK dhe akreditimi i ofruesve të AAP

Bazuar në planin e punës gjatë vitit 2022, AKK ka realizuar aktivitetet që kanë të bëjnë me validimin dhe aprovimin e kualifikimeve dhe akreditimin e ofruesve të AAP-së, vlerësimin dhe vizitat e ekspertëve në institucionet përkatëse, dokumentacionit, hapësirave dhe pajisjeve për punë, stafin e nevojshëm dhe aspektet tjera të rëndësishme.

Në procesin e vlerësimit, përveç stafit të AKK, sipas legjislacionit në fuqi AKK ka angazhuar ekspertë të jashtëm sipas sektorëve dhe fushave përkatëse. Në funksion të njësimit të procedurave dhe kredibilitetit të procesit, janë organizuar takime konsultative me ekspertët e përfshirë dhe palë tjera relevante. Takimet kishin qëllim informues, metodologjinë lidhur me procesin e validimit dhe akreditimit të institucioneve aplikuese dhe dinamikën e procesit e transparencën, etj.

Për të realizuar funksionet dhe përgjegjësitë, AKK gjatë vitit ka realizuar dhe zhvilluar aktivitetet si në vijim:

- Konsultimin me përfaqësuesit e AAP dhe palët relevante;
- Shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjes së institucioneve aplikuese nga AKK përmes listës së kontrollit;
- Aprovimin e dosjes aplikuese nga KD i AKK;
- Përzgjedhjen e ekipit të ekspertëve për vlerësim;
- Shqyrtimin e dosjes së institucioneve aplikuese nga ekipi i ekspertëve;
- Vizita në institucione;
- Hartimin e raporteve të vlerësimit për validim të kualikimit dhe akreditim të institucionit;
- Aprovimin e raporteve vlerësuese nga KD i AKK



Pamje nga punëtoritë në procesin e akreditimit të IAAP



Takim me rastin e procesit të validimit dhe akreditimit

Të gjitha proceset që ndërlidhen me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe komponentët e saj janë zhvilluar sipas legjislacionit, përfshirë këtu fazën e aplikimit, vlerësimin e dosjeve, vizitat në teren si dhe procedimin e raporteve vlerësuese.

AKK për periudhën raportuese ka procesuar dhe pastaj ka aprovuar nëpërmjet KD të AKK, dyzet (40) kërkesa për hyrje në procesin e akreditimit si dhe tetëdhjetë e një (81) kualifikime për hyrje në procesin e validimit (shih tabelen nr. 3).

Sektori i Kualifikimeve dhe sektori i Sigurimit të Cilësisë gjatë kësaj periudhe ka zhvilluar dhe zbatuar gjithsej pesëdhjetë (50) procese të akreditimit, si dhe tetëdhjetë e tetë (88) procese të validimit të kualifikimeve profesionale në KKK.



Takim me rastin e procesit të validimit dhe akreditimit



Takim me rastin e procesit të validimit dhe akreditimit

Në tabelën nr. 3 janë paraqitur të dhënat për aplikacionet e shqyrtuara nga stafi i AKK dhe të aprovuara nga KD i AKK për vitin 2022.

Nr.	Institucioni	Kualifikimet	Numri i Kualifikimeve
1	Gutenberg Academy	Gjuhë Angleze	2
		Gjuhë Gjermane	
2	Euro School	Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë	3
		Asistent Dentar	
		Teknik i Farmacisë	
3	Qendra e Gjuhëve EU	Kurse të Gjuhës Gjermane	1
4	Korabi Corporation	Ndihmës Kuzhinier	1
5	Qendra Model	Rrobaqepës dhe Modelist	1
6	Gjimnazi Britanik për Teknologji	Teknologji Informative	1
7	Angel	Grim	2
		Manikyr	
8	Training Center "Dekoriti"	Zdrukthëtar	1
9	Deutschentrum Kosovo	Gjuhë Gjermane	1
10	Oxford Studio me 11 Qendra	Gjuhë Angleze	1
11	Vivienne Academy	Parukeri	2
		Grimer	
12	Beetroot Academy	Inxhinier Softueri	1
13	Autoshkolla "Qendra"	Instruktor i vozitjes	1
14	Qendra për Studime Universitare (QSU)	Nëntoger në Forcat e Armatosura	1
15	ECO Education Center Oxford	Gjuhë angleze	1
16	Kolegji Pjeter Budi	Ndihmës Kuzhinier	2
		Furrtari	
17	Anadrinia Med	Bashkëpunëtor profesional i infermierisë	1
18	Kolegji ISPE	Teknik i Farmacisë	2
		Teknik i Fizioterapisë	
19	Kosova Women 4 Women	Rrobaqepës	2
		Modelist	
20	Instituti për Aftësime Profesionale KTC	Bërës ëmbëlsirash	12
		Kuzhinier	
		Ndihmës Kuzhinier	
		Picamen	
		Grimer	
		Parukeri	
		Pedikyrist	
		Manikyrist	
		Instalues i ngrohjes qendrore	
		Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit	
		Instalues elektrik	
		Murator dhe punëtorë të ngjashëm	

21	Oskar Kammer Schule	Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë	2
		Asistent i kujdesit social dhe shëndetësor	
22	Rezonanca	Teknik Dentar	4
		Asistent i Fizioterapisë	
		Teknik i Farmacisë	
		Bashkëpunëtor profesional i infermierisë	
23	UBT	Teknik i Laboratorit Mjekësor	2
		Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë	
24	SIDI EDUCATION	Gjuhe Angleze, Niveli A deri ne C	1
25	Akademia profesionale DC	Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë	1
26	IMPERIUM	Teknik i Farmacisë,	4
		Laborant Shëndetësor,	
		Asistent Dentar,	
		Bashkëpunëtor i Infermierisë	
27	Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë se Kosovës "IADK"	Bërës Ëmbëlsirash	3
		Punëtor për mbledhje, kultivim dhe përpunim të frutave të malit	
		Punëtor për mbledhje, kultivim dhe përpunim të bimëve mjekësore-aromatike	
28	Këshilli i Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare	Bashkëpunëtor Profesional i Punëve Sociale	3
		Profesionistët e Punëve Sociale dhe te Këshillimit	
		Menaxher i Mirëqenies Sociale	
29	Kolegji Biznesi	Ekspert për Siguri dhe shëndet ne pune	1
30	Shehu	Zdrukthëtar	1
31	Akademia Evolucion	Modelist, prerës dhe punues të tekstilit dhe të tjerë të ngjashëm	2
		Rrobaqepës, rrobaqepësit, gëzofpunuesit dhe kapelabërës	
32	PBC Academy	Zhvillues softueri	1
33	Qendra e Aftësimit Profesional - Gjakovë	Asistent Administrativ	2
		Menaxher i ndërmarrjeve mikro dhe te vogla	

34	Qendra e Aftësimit Profesional - Mitrovicë	Saldim	2
		Zdrukthëtar	
35	Qendra e Aftësimit Profesional - Prishtinë	Furrtar	2
		Bërës ëmbëlsirash	
36	Qendra e Aftësimit Profesional - Prizren	Nëpunës i kontabilitetit	2
		Automekanik	
37	Qendra e Aftësimit Profesional - Ferizaj	Saldues	2
		Instalues Elektrik	
38	Qendra e Aftësimit Profesional - Gjilan	Saldues	2
		Zdrukthëtar	
39	Qendra e Aftësimit Profesional - Pejë	Qumështar	4
		Menaxher i ndërmarrjeve mikro dhe te vogla	
		Ndihmës Kuzhinier	
		Nëpunës kontabiliteti	
40	Qendra Burimore "Nëna Terezë"	Gjuha e Shenjave sipas CEFR A deri në B	1

Në tabelën nr. 4 janë paraqitur të dhënat për kualifikimet e validuara/rivaliduara në KKK si dhe institucionet e akredituara/ riakredituara për vitin 2022

Nr.	Institucioni	Kualifikimet
1	Akademia Tempulli	Instruktor i Shoferit.
2	Creative Education	Kurse të Gjuhës Gjermane,
		Kurse të Gjuhës Angleze.
3	I2 Defense	Trajnerët, Instruktorët dhe Zyrtarët Sportiv.
4	Smart Center	Kurse të Gjuhës Gjermane,
		Kurse të Gjuhës Angleze.
5	Kolegji Europian i Kosovës	Ekspert për Siguri dhe Shëndet në Punë;
		Shitja dhe Shërbimi i Klientit;
		Teknik i Zhvillimit të Softuerit.
6	Akademia e Kosovës për Siguri Publike	Zyrtar Doganor;
		Zyrtar Policor;
		Zyrtar Sprovues;
		Zyrtar Korrektues;
		Inspektor i Inspektoratit Policor të Kosovës;
		Zjarrfikës.

7	International Business College Mitrovica	Asistent Administrativ;
		IT Help Desk;
		Menaxher i Ndërmarrjeve Mikro dhe të Vogla;
		Shitje dhe Shërbimi i Klientit.
8	Kolegji Universum	Nëpunës i Kontabilitetit.
9	Asociation Loyola-Gymnasium	Operatorë i Robotëve Industrial - Teknik i Drejtimit të Proceseve.
10	Gjimnazi Britanik për Teknologji	Teknologji e Informacionit.
11	Elektrowati, me qendrat: Pejë dhe Prishtinë	Instalues Elektrik.
12	QAP "TERMO HIDRAULIKU"	Instalues i Ujësjellësit, Ngrohjes dhe Klimatizimit.
13	UNI BB, me qendrat: Prishtinë, Pejë, Ferizaj dhe Gjilan	Rrobaqepës, prerës dhe punues të tekstilit dhe të tjerë të ngjashëm;
		Modelist, prerës dhe punues të tekstilit dhe të tjerë.
14	Qendra e Aftësimit Profesional-Diakonie Training Center	Instalues i Ngrohjes Qendrore;
		Instalues i Ujësjellësit dhe Kanalizimit;
		Instalues elektrik.
15	"Britannica ELT School", me dy qendra në Prishtinë	Gjuhë angleze
16	JCODERS, me qendrat: Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjilan dhe Mitrovicë	Junior Coders;
		Junior Full Stack Developers.
17	LB GROUP & EKOPACK	Bërës Ëmbëlsirash.
18	"BEETROOT ACADEMY" SH.P.K	Zhvillues i Aplikacioneve në Ueb.
19	Qendra e Kompetencës - Prizren	Këshilltar për Karrierë.
20	IAP "Dekoriti Training Center"	Zdrukthëtar.

21	IAAP URA VIZION "EUROSCHOOL"	Asistent Dentar;
		Teknik i Farmacisë;
		Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë.
22	Shkolla e Mesme e Lartë e Mjekësisë Imperium	Asistent Dentar;
		Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë;
		Teknik i Farmacisë;
		Teknik i Laboratorit Mjekësor.
23	Kolegji ISPE	Asistent i Fizioterapisë;
		Teknik i Farmacisë.
24	Qendra Inovative Korabi Corporation	Ndihmës Kuzhinier.
25	Alma Mater Europaea Campus Colege Rezonanca & Poliklinika Rezonanca	Asistent i Fizioterapisë;
		Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë;
		Teknik Dentar;
		Teknik i Farmacisë;
26	Kolegji Ndërkombëtar për Biznes dhe Teknologji "UBT"	Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë;
		Teknik i Laboratorit Mjekësor.
27	Shkolla e Mesme e Lartë e Mjekësisë "ANADRINIA MED"	Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë.
28	Shkolla e Mesme e Lartë e Mjekësisë "AKADEMI PROFESIONALE DC"	Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë.
29	Instituti Profesional "ATC"	Instalues i Ujësjellësit dhe Kanalizimit;
		Menaxher i Ndërmarrjeve Mikro dhe të Vogla.
30	"MEISTER"	Operator i Robotëve Industrial - Teknik i Drejtimit të Proceseve Mekatronike;
		Instalues Elektrik;
		Instalues i Ngrohjes, Klimatizimit dhe Ujësjellësit.
31	Qendra për Studime Universitare – QSU	Nëntoger në Forcat e Armatosura.

32	"Gutenberg Academy"	Gjuhë Gjermane, Niveli A1 deri në C1;
		Gjuhë Angleze, Niveli A1 deri në C1
33	"Deutschzentrum Kosovo", nëndegën Mitrovicë	Gjuhë Gjermane, Niveli A1 deri në C1.
34	"Qendra e Gjuhëve të Huaja - EU"	Gjuhë Gjermane, Niveli A1 deri në C1.
35	ANGEL ACADEMY L.L.C, Prishtinë	Manikyrist;
		Grimer.
36	IBC NAILS SH.P.K - Prishtinë	Manikyrist;
		Pedikyrist.
37	IAAP "Eco - Education Center Oxford" SHPK – Gjilan, me dy qendra	Gjuhë Angleze, Niveli A1 deri në C1
38	VIVIENNE ACADEMY L.L. - Prishtinë	Grimer
		Parukier.
39	INSTITUTI PROFESIONAL ATC SH.P.K. - Prishtinë	Instalues Elektrik.
40	QSE "DON BOSKO" - Prishtinë	Teknologji Informative dhe Komunikimit.
41	KOLEGJI" PJETËR BUDI" - Prishtinë	Furrtar;
		Ndihmës Kuzhinier.
42	OJQ Qendra për Arsim dhe Këshillim Profesional Gjon Nikolle Kazazi - Gjakove	Teknologji Informative dhe Komunikimit.
43	Euro School	Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë;
		Asistent Dentar;
		Teknik i Farmacisë.
44	Qendra e Gjuhëve EU	Gjuhë Gjermane.
45	Deutschentrum Kosovo, nëndegën Mitrovicë	Gjuhë Gjermane.

46	Oxford Studio, me 11 qendra: Prishtinë (4 qendra), Prizren (2 qendra), Gjilan (2 qendra), Klinë (1 qendër), Istog (1 qendër), Gurrakoc (1 qendër)	Gjuhë Angleze.


Tabela nr. 5. Institucionet e akredituara për zbatimin e njohjes së mësimit paraprak (NjMP) në vitin 2022

1	Kryolan Kosova	Parukeri
2	Qendra e Trajnimit – Korporata Energjetike e Kosovës	Instalues Elektrik

Tabela nr. 6. AKK që nga muaji shtator deri në muajin dhjetor 2022 ka realizuar procesin e validimit dhe akreditimit për 10 institucione me 30 kualifikime. Draft raportet vlerësuese për këto institucione janë finalizuar dhe presin shqyrtimin nga KD i AKK në vitin pasues.

Nr.	Institucioni	Kualifikimet
1	Kosova Women 4 Women , me kualifikimet:	1.1. Rrobaqepës
		1.2. Modelist.
2	Instituti për Aftësime Profesionale KTC, me kualifikimet:	2.1. Bërës ëmbëlsirash;
		2.2. Ndihmës Kuzhinier;
		2.3. Picamen;
		2.4. Grimer;
		2.5. Parukeri;
		2.6. Pedikyrist;
		2.7. Manikyrist;
		2.8. Instalues i ngrohjes qendrore;
		2.9. Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit;
		2.10. Instalues elektrik;
		2.11. Murator dhe punëtorë të ngjashëm.
		2.11. Murator dhe punëtorë të ngjashëm.
3	SIDI EDUCATION, me qendrat: Fushë Kosovë, Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë, Pejë, Skenderaj, me kualifikimin:	3.1. Gjuhë Angleze.

4	"Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë se Kosovës (IADK)", me kualifikimet:	4.1. Bërës Ëmbëlsirash;
		4.2. Punëtor për mbledhje, kultivim dhe përpunim të frutave të malit
		4.3. Punëtor për mbledhje, kultivim dhe përpunim të bimëve mjekësore-aromatike.
5	"Këshilli i Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare", me kualifikimet:	5.1. Bashkëpunëtor Profesional i Punëve Sociale;
		5.2. Profesionistët e Punëve Sociale dhe te Këshillimit;
		5.3. Menaxher i Mirëqenies Sociale.
6	Qendra e Aftësimit Profesional Gjakovë, me kualifikimet:	6.1. Asistent Administrativ;
		6.2. Menaxher i ndërmarrjeve mikro dhe te vogla.
7	Qendra e Aftësimit Profesional - Prishtinë, me kualifikimet:	7.1. Furrtar;
		7.2. Bërës ëmbëlsirash.
8	Qendra e Aftësimit Profesional - Prizren, me kualifikimet:	8.1. Nëpunës i kontabilitetit;
		8.2. Automekanik.
9	Qendra e Aftësimit Profesional - Ferizaj, me kualifikimet:	9.1. Saldues;
		9.2. Instalues Elektrik.
10	Qendra e Aftësimit Profesional - Gjilan, me kualifikimet:	10.1. Saldues;
		10.2. Zdrukthëtar.



Diagrami 1. Kualifikimet në KKK sipas sektorëve për vitin 2022.

Njohja e Mësimit Paraprak (NjMP)

Njohja e mësimit paraprak, rregullohet me Ligjin nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare në Republikën e Kosovës. Një nga objektivat kryesore të ligjit është përmirësimi i vlerësimit të kualifikimeve, duke përfshirë përgatitjet për njohjen e mësimit paraprak.

Njohja e mësimit paraprak (NjMP), i referohet njohjes së mësimit formal, joformal dhe informal në punë apo nëpërmjet aktiviteteve të tjera, të cilat janë të pranueshme nëpërmjet procesit të identifikimit, vlerësimit dhe njohjes formale të shkathtësive të tuaja.



Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e NjMP

NjMP mund të zbatohet vetëm nga institucionet e akredituara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK). Korniza e qartë ligjore ekziston për akreditimin e institucioneve për zbatimin e NjMP në AAP, që përcakton mekanizmat e brendshëm dhe të jashtëm të Sigurimit të Cilësisë (SC). Për t'u akredituar për zbatimin e NjMP, institucionet duhet ti plotësojnë kriteret specifike siç janë mekanizmat e brendshëm të sigurimit të cilësisë, pajisjet specifike, etj. Kriteret e akreditimit që duhet të përmbushen nga ofruesi që aplikon për ta zbatuar NjMP në AAP janë të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.

Në tabelën nr 7 janë paraqitur të dhënat e institucioneve të akredituara për zbatimin e NjMP për vitin 2022.

Nr.	Ofruesi/institucioni	Qyteti	Niveli	Kualifikimi
1	Kryolan Kosova	Prishtinë	IV	Parukeri
2	Qendra e Trajnimit – Korporata Energjetike e Kosovës	Obiliq	III	Instalues Elektrik

Sektori i sigurimit të cilësisë

Ky sektor edhe këtë vit ka zhvilluar aktivitete këshillëdhënëse dhe informata kthyese për proceset e sigurimit të cilësisë dhe akreditimit. Po ashtu, këtë vit ky sektor ka pranuar raporte të vetëvlerësimit nga institucione të ndryshme bazuar në vitin akademik dhe kalendarik për të dhënë më tutje informata kthyese për raportet e vet-vlerësimit e institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional, dhe indikatorëve sipas Kornizës Kombëtare të Sigurimit të Cilësisë.

Ky sektor po ashtu ka qenë pjesëmarrës në disa aktivitete të ndërlidhura me sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë si brenda dhe jashtë vendit si: Forumi i Sigurimit të Cilësisë i organizuar nga Fondacioni Evropian i Trajnimeve (ETF), pjesëmarrje në takimet për Sigurimin e Cilësisë në nivel rajonal dhe vendor të mbështetura nga projektet ERISEE, Alled2, Lux Dev, etj.

AKK gjatë këtij viti, me mbështetje nga projekti GIZ (Fits for Job) organizoi hulumtimin me palët e interesit rreth ndikimit të KKSC për zbatimin e sigurimit të cilësisë në AAP. Në këtë hulumtim morën pjesë drejtorë, koordinatorë për Sigurim të Cilësisë të shkollave publike dhe private si dhe përfaqësues tjerë të palëve të interesit në fushën e AAP. Në bazë të rezultateve të këtij hulumtimi, AKK mbështeti procesin e rishikimit të KKSC, duke mbajtur disa takime dhe punëtori të cilat kishin për synim rishikimin e principeve dhe indikatorëve të Kornizës Kombëtare për Sigurimin e Cilësisë (KKSC) në Arsimin dhe Aftësimin Profesional. Në fund, AKK organizoi puntori përmbyllëse në të cilën morën pjesë akterë të ndryshëm duke filluar nga drejtorë të shkollave të AAP, koordinatorë për Sigurim të Cilësisë të shkollave të AAP, përfaqësues nga MASHT, Inspektoriati SIA MASHT, IAAPRr, etj., të cilët patën rastin të japin komente rreth këtij dokumenti.

Si rrjedhojë e gjithë këtij procesi, përfshirë këtu analizën dhe mbledhjen e të dhënave nga palët e interesit, finalizua dokumenti i KKSC, i cili më pas u aprovua nga Këshilli Drejtues i AKK dhe u publikua në uebfaqen e AKK.



Puntori për rishikimin e Kornizës Kombëtare për Sigurimin e Cilësisë

Mekanizmi kryesor për zbatimin e Kornizës Kombëtare të Sigurimit të Cilësisë është raporti i vetë-vlerësimit (RVV) i institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional. RVV e rishikuar, tani është i organizuar në gjashtë parime të cilësisë të ndara me gjithsej tregues, duke përfshirë edhe tregues që ndërlidhën me Njohjen e Mësimit Paraprak (NjMP) dhe Mësimin në Vendin e Punës (MVP).

Procesi i rishikimit të KKSC i përkrahur nga GIZ i paraprinë fazave tjera të zhvillimeve në këtë fushë, përcjellur me zhvillimet tjera siç janë: Zhvillimi i udhëzuesit për përdoruesit dhe zbatuesit e KKSC dhe zhvillimi i platfomës së KKSC, e cila do të mbështesë një qasje më inovative, krijimin e një rrjetizimi të IAAP dhe fuqizimin e rolit të sigurimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë.



Pjesëmarrje e AKK në takimin me ETF për sigurim të cilësisë

Sektori i Monitorimit të IAAP pas akreditimit

Zbatimi i monitorimit është i përcaktuar me Ligjin nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, sipas dinamikës së ndjekur, ka zhvilluar mekanizmat për funksionalizimin e zbatimit të procesit të monitorimit në IAAP pas akreditimit, me qëllim të monitorimit të performancës së tyre dhe konstatimit të përmbushjes së kritereve të validimit dhe akreditimit.

AKK me metoda të ndryshme të raportimit me qëllim të zbatimit të mekanizmave të monitorimit, në mënyrë efektive ka monitoruar përformacën e IAAP përmes monitorimit nga distanca dhe monitorimit fizik në IAAP. Pjesë e aktiviteteve fizike kanë qenë dy institucione të cilat janë monitoruar:
Instituti profesional për përkrahje dhe punësim "Dituria" me kualifikimin: Murator dhePunëtor të ngjashëm, Niveli III, dhe Institucioni "Camellias" kualifikimi Parukeri, Niveli III.

Këto vizita janë realizuar me panele të ekspertëve të kualifimeve përkatëse, ku dhe është dhënë një pasqyrë e qartë lidhur me përformacën e IAAP.

Po ashtu janë dhënë rekomandime dhe këshilla për përimirësim ku këto duhet të jenë objekt i vazhdueshëm monitorimi në mënyrë që të sigurohe se janë duke u zbatuar mekanizmat e sigurimit të ciliësë gjatë gjithë procesit që nga regjistrimi e deri në certifikimin e kualifikimeve.
Pas këtyre fazave monitoruese, AKK ka zhvilluar metodologji për raportimin e numrit të mësimdhënësve dhe trajnerëve të institucioneve të akredituara si dhe të dhënat për kandidatët dhe komponentet tjera rreth certifikimit të tyre konform vendimeve të KD AKK.
Institucionet e akredituara/ofruesit sipas ligjit në fuqi kanë për obligim që certifikatat dhe diplomat e tyre ti sjellin në AKK për t'i vulosur. AKK mban shënimet e kandidatëve/nxënësve të certifikuar nëpërmjet një regjistri. Kjo procedurë mbështetet në Ligjin për Kualifikimet Kombëtare, Neni 15, Rregullimi i dhënies së kualifikimeve, pika 2. Certifikatat dhe diplomat e dhëna për të gjitha kualifikimet në kornizë miratohen me vulë të autoritetit dhe përfshijnë titullin e aprovuar të kualifikimit, nivelin e tij në KKK, lloji i kualifikimit dhe informata të tilla varësisht nga kërkesa e AKK. Gjatë kësaj periudhe cdo certifikatë/diplomë verifikohet nga stafi i AKK lidhur me grupin e paraqitur, kohën e kaluar konform numrit të kredive, lidhjen logjike të moduleve, etj.
Gjatë këtij viti, AKK ka verifikuar dhe vulosur rreth 8017 certifikata të kandidatëve të certifikuar nga institucionet e akredituara.



Pamje nga vizita e procesit të monitorimit pas akreditimit të IAAP

Tabela nr. 8 Të dhënat e kandidatëve të certifikuar në IAAP e akredituara për vitin 2022

INSTITUCIONI	QYTETI	KUALIFIKIMET	Numri i Certifikatave
American Beauty School		Grim	544
		Manikyr	
		Parukeri	
Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP)	Vushtrri	Polic i ri	48
		Inspektor i inspektoratit Policor të Kosovës	
		Zyrtarë Doganor	
		Zyrtarë Korrektues	
		Zyrtarë Sprovues	
		Zjarrëfikës	
Camellias	Prishtinë	Manikyrist/Manikyriste	113
		Grim	
		Parukeri	
Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (SHKÇAK)	Prishtinë	Ekspert i tatimor	135
		Ekspert i lartë tatimor	
		Ekspert i licensuar i forenzikës financiare	
		Auditor i Brendshëm i Certifikuar	
		Auditor i Certifikuar	
		Auditor i Certifikuar në Sektorin Publik	
		Kontabilist i Certifikuar	
		Teknik i Kontabilitetit	
Qendra e Bukurisë "Coiffure School"	Prishtinë	Manikyrist/Manikyriste	62
		Grim	
		Parukier/Parukiere	
QAP Prishtinë	Prishtinë	Asistent Administrativ	23
		Furrtari	
i2 Defense	Prizren	Trajnerët,instruktorët dhe zyrtarët sportiv	20
Kolegji Evropian I Kosovës	Prishtinë	Shitje dhe shërbim i klientit	14
		Teknik i zhvillimit te softëerit	
Smart Center	Prishtinë	Gjuhë angleze	326
		Gjuhë gjermane	
UNI BB Sh.P.K	Prishtinë Ferizaj	Modelist, prerës dhe punues të tekstilit dhe të tjerë të ngjashëm	64
	Pejë,Prizren	Rrobaqepësit,rrobaqepëset gëzofpunuesit dhe kapelabërësit	

Oxford Studio	Prishtine, Prizren, Gjilan, Klinë,Istog, Gurakoc	Gjuhë Angleze	2487
	Fushë Kosovë Mitrovicë	Gjuhë Angleze	
Diakonie Training Center -DTC	Mitrovicë	Parukier/Parukiere	142
		Instalues elektrik	
		Instalues i ngrohjes qëndrore	
		Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit	
Italian Beauty Cosmetics - N.Sh (IBC)	Prishtinë	Manikyrist/Manikyriste	762
		Pedikyrist/Pedikyriste	
Instituti Profesional "ATC SH.P.K"	Prishtinë	Instalues elektrik	79
		Instalues i ujësjellësit	
		Menaxher i ndërrmarrjeve mikro dhe te vogla	
		Gjuhë angleze	
		Bërës ëmbëlsirash	
		Ndihmës kuzhinier	
		Picier	
		Automekanik	
Elektrowati Sh.P.K	Prishtinë Pejë	Instalues elektrik	64
QAP Ferizaj	Ferizaj	Saldim	39
		Instalues elektrik	
QAP Pejë	Pejë	Asistent Administrativ	15
		Instalues elektrik	
		Qumështar	
QAP Prizren	Prizren	Saldim	12
		Grimer/Grimere	
Kolegji Pjetër Budi	Prishtinë	Teknologji informative dhe e komunikimit ECDL Base	13
		Teknologji informative dhe e komunikimit ECDL Standard	
		Teknologji informative dhe e Komunikimit ECDL Advanced	
QAP Gjilan	Gjilan	Metalpunues	17
		Saldim	
QAP Mitrovicë	Mitrovicë	Metalpunues	40
		Saldim	
Britanica-ELT	Prishtinë	Gjuhë gjermane	5

		Gjuhë angleze	
ECO-Education Oxford	Gjilan	Gjuhë angleze	280
Inciativa per zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës- IADK	Vushtrri	Teknik i blegtorisë	13
		Prodhuesit e kulturave të përziera dhe të kafshëve	30
		Konservues i frutave,perimeve dhe të ngjashme	
Professional Beauty Academy	Prishtinë	Grimer/Grimere	103
		Manikyrist/Manikyriste	
		Parukier/Parukiere	
QAP Gjakovë	Gjakovë	Asistent Administrativ	31
		Instalues elektrik	
		Saldim	
Aleanca Franceze	Prishtinë	Gjuhë frënge	11
PBC Academy	Prishtinë	Zhvillues i softëerit	8
Arnisa-Z	Pejë	Rrobaqepësit,rrobaqepëset, gëzofpunuesit dhe kapelabërësit	18
		Modelist, prerës dhe punues të tekstilit dhe të tjerë të ngjashëm	
Shkolla Digjitale	Prishtinë, Ferizaj	Programer Junior	151
Tempulli Sh.P.K	Prishtinë	Trafik Rrugorë	1
		Instruktor i shoferëve	
		Operuesit e kamioneve per ngritje	
		Shoferët e veturave , taksive dhe furgonave	
		Operuesit e impianteve të vinçave , ngritësve dhe te ngjashëm	
English Language School	Prishtinë	Gjuhë angleze	7
IAPP Dituria	Prizren	Murator dhe punëtorët e ngjashëm	172
IAPP Dituria - (Aneks Akreditim)	Prizren	Murator dhe punëtorët e ngjashëm	
Infinit Qatar Traning Center	Prishtinë	Gjuhë Angleze	1
Cacttus Education	Prishtinë	Administrator i rrjetave dhe sistemeve kompjuterike	378
		Zhvillues i ëeb-it dhe i aplikacioneve mobile	
Qendra e trajnimit- KEK	Obiliq	Instalues elektrik	4
Getting Competent	Prishtinë	Instruktor në vendin e punës	46
PROED	Prishtinë	Zhvillues softueri	5
UBT	Prishtinë	Gjuhë Angleze	103

Agjensioni i Përkrahjes së Punësimit në Kosovë (APPK)	Prishtinë	Gjuhë gjermane	
		Menaxheri i ndërmarrjeve mikro dhe të vogla	38
KRYOLAN KOSOVA	Prishtinë	Grim	196
		Parukeri	
Qendra e trajnimit – "I.A.P Shehu"		Zdrukthëtar	106
Shkolla Digjitale PEJË Sh.P.K	Pejë	Programer Junior	10
Shkolla Digjitale Sh.P.K	Prizren	Programer Junior	37
QAP SAUDA	Pejë	Grim	31
		Parukeri	
INTERNATIONAL BEAUTY BRANDS	Prishtinë	Manikyr	50
STAR NAILS ACADEMY SHPK	Prishtinë	Manikyr	11
Qendra Sociale Edukative Don Bosko	Prishtinë	Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit	27
		Instalues elektrik	
		Instalues i ngrohjes qëndrore	
Deutschzentrum Kosovo	Prishtinë	Kurse të gjuhës gjermane niveli A1-C1	110
	Gjilan	Kurse të gjuhës gjermane niveli A1-C1	77
Universiteti Haxhi Zeka	Pejë	Prodhuesit e kulturave të përziera dhe të kafshëve	16
Qendra Inovative Korabi	Çagllavicë	Furrtari	17
	Çagllavicë	Bërës ëmbëlsirash	
Neë Born Master	Suharekë	Murator dhe punëtorët e ngjashëm	
Oda Ekonomike e Kosovës	Prishtinë	Instruktor ne vendin e punës	22
		Vlerësues i patundshmërive	
Associates for Finance and Accounting Services - "AFAS"	Prishtinë	Nëpunës i kontabilitetit	62
Instituti për Kontabilitet, Auditim dhe Financa (IKAF)	Prishtinë	Nëpunes Kontabiliteti	255
		Teknik i Kontabilitetit	
		Kontabilist i Certifikuar	
		Auditor i Certifikuar	
		Auditor i brendshëm në sektorin privat dhe publik	
		Vlerësues i bizneseve i certifikuar	
		Vlerësues i bizneseve i licencuar	
		Ekspert i licencuar i forenzikës financiare	

		Këshilltar tatimor	
		Këshilltar tatimor i licencuar	
		Kontrollor i certifikuar	
		Kontrollor i licencuar	
		Auditor i it i certifikuar	
		Menaxher i riskut i certifikuar	
		CFO i certifikuar	
		Zyrtar i certifikuar ne menaxhimin e financave publike	
		Certifikim ne IPSAS	
AAB Shkolla Profesionale Gjermane	Prishtine Fushe Kosove		42
Pretty Woman Academy	Prishtine	Estetiste	15
Creative Education	Prishtine	Gj Gjermane	182
Kolegji Universum	Prishtinë	Nëpunes i Kontabiliteti	
Asociation "Loyola-Gymnasium"	Prizren	Operatorë i Robotëve Industrial - Teknik i Drejtimit të Proceseve	4
QAP TERMO HIDRAULIKU	Pejë	Instalues i ujësjellësit, ngrohjes dhe klimatizimit	14
Britannica ELT School	Prishtinë	Gjuhë angleze	5
BEETROOT ACADEMY	Prishtinë	Zhvillues i aplikacioneve ne ueb	19
IAAP "Eco - Education Center Oxford" SHPK – me dy qendra	Gjilan	Gjuhë Angleze	248
VIVIENNE ACADEMY L.L	Prishtinë	Grimer	38
		Parukier	
KOLEGJI "PJETËR BUDI"	Prishtinë	Furrtar	13
	Prishtinë	Ndihmës Kuzhinier	
		Totali:	8017

[9] Të dhënat e paraqitura në tabelë janë si rezultat i listave të dërguara nga IAAP dhe të verifikuara nga AKK.

Promovimi i KKK

AKK-ja ka zhvilluar dhe zbatuar strategji të vazhdueshme të komunikimit për të mbajtur të informuar të gjitha palët e interesit, duke përfshirë këtu edhe publikun e gjerë. Kjo është bërë nëpërmjet aktiviteteve dhe mjeteve të ndryshme, si në vijim:

- Mbajtja e takimeve të rregullta me palët e interesit (ofruesve publik, privat, institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional, si dhe partnerët zhvillimorë);
- Pjesëmarrje në punëtori/seminare;
- Pjesëmarrje në media elektronike dhe të shkruara;
- Mirëmbajtja dhe përditësimi i uebfaqes;
- Editimi dhe shpërndarja e publikimeve të ndryshme,
- Shpërndarjen e certifikatave për institucionet ofruese nga procesi i validimit dhe akreditimit;
- Popullimi i informatave në softuer, etj.



Pjesëmarrje e AKK në takimin e Grupit Këshillues të KEK



Takim pune me Komisionin Parlamentar për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Rini dhe Sport

Takimet me palët e interesit

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, për të planifikuar, organizuar dhe zbatuar sa më mirë rregullimin e KKK, ka mbajtur takime të shumta, që kryesisht kishin të bëjnë me: informimin mbi procesin e zhvillimit dhe verifikimit të standardeve të profesionit; mbështetjen dhe udhëzimet rreth aplikimit për procesin e validimit dhe akreditimit dhe NjMP. Po ashtu, AKK ka mbajtur takime me palët e interesit lidhur me informimin për llojet e kualifikimeve, progresin, shtigjet, certifikimet, sigurimin e cilësisë si dhe benefitet e sistemit kombëtar të kualifikimeve.

Organizimi i punëtorive dhe seminareve

AKK gjatë këtij viti ka zhvilluar punëtori dhe seminare me qëllim të zhvillimit dhe zbatimit të aktiviteteve të ndryshme si dhe përfaqësuesit e AKK kanë qenë pjesëmarrës në aktivitete të ndryshme të organizuara nga palët e interesit. Punëtoritë e organizuara nga AKK lidhur me zhvillimin e dokumenteve të brendshme janë si në vijim:

- Punëtori për rishikimin e Kornizës Kombëtare të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin dhe Aftësimin Profesional;
- Trajnimi i stafit për zbatimin e NjMP për organizatat e interesuara
- Trajnimi për zhvillimin e mekanizmave të brendshme për zbatimin e NjMP dhe përgatitja për procesin e akreditimit.
- Trajnimi i trajnerëve për Koordinator, Mentor dhe Vlerësues të NjMP.
- Trajnimi për vlerësues te jashtëm për procesin e akreditimit për zbatimin e NjMP
- Plani dhe raporti I punës.



Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e NjMP

AKK gjithashtu ka qenë pjesëmarrëse edhe në aktivitete të ndryshme të organizuara nga institucione dhe partnerë zhvillimor si në vijim:
- Aktivitet në lidhje me zhvillimin e dokumenteve strategjike, ligjore dhe proceseve tjera ka zhvilluar takime të rregullta me grupe të ndryshme punuese për: Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2022-2026; Projektligjin për Arsimin e Lartë në Kosovë; Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për Akreditim; Projektligjin për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme; KAAPRr, etj.
- Aktiviteti i organizuar nga MASHTI me mbështetjen e Zyrës së UNICEF- it në Kosovë për hartëzimin e kualifikimeve të sistemit arsimor të Kosovës me ISCED 11.

Ky proces bënë të mundur krahasimin e rezultateve të arsimit dhe treguesve arsimor me të gjithë shtetet tjera dhe përshtatjen e programeve arsimore në një kategori të krahasueshme ndërkombëtarisht.

- AKK ka qenë aktive gjithashtu edhe në një mori takimesh në raportimin tek nën-komitetit për Inovacion, shoqëri informative dhe politika sociale lidhur me zhvillimin e raportit për zbatimin e konkluzioneve nga viti i kaluar, zhvillimet legjislative, zbatimit të politikave dhe të kapaciteteve rreth zbatimit të masave të: Programit për Reforma në Ekonomi - PRE 2020-2022.
- MASHTI me mbështetjen e Lux Development ka zhvilluar aktivitet për zhvillimin e bazës ligjore sekondare për ofrimin dhe rregullimin e Nivelit V të KKK. AKK ka qenë pjesë në takimet e këtij zhvillimi që nga krijimi i grupit punues e deri tek drafti final i këtij dokumentit.
- Aktivitet i grupeve punuese për përgatitjen e kontributit (inputit) të institucioneve të Republikës së Kosovës për Raportin e KE-së për Kosovën – 2021 nga perspektiva e zhvillimeve në fushën e edukimit specifikisht në fushën e arsimit dhe aftësimit profesional (AAP), sigurimin e cilësisë, kualifikimeve, etj.
- AKK gjithashtu ka qenë pjesë e aktiviteteve për zhvillimin e programit të Gjuhës së Shenjave, proces ky i udhëhequr nga MASHTI për Qendrat Burimore dhe Shoqatës Kosovare e të Shurdhërve dhe i ndihmuar nga Komisioni Evropiane. AKK në këtë proces ka luajtur rolin mbështetës lidhur me informatat për mundësitë dhe kualifikimin, nevojat për përgatitjen e dokumentacionit përcjellës për procesin e aplikimit për validim dhe akreditim, etj.



Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e NjMP

Botimi dhe shpërndarja e publikimeve dhe materialeve promovuese

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve ka qenë i angazhuar në dizajnimin, editimin, publikimin dhe shpërndarjen e një sasie të konsiderueshme të dokumenteve të nxjerra nga AKK-ja.

AKK, dokumentet relevante kryesisht i ka publikuar në formë të shtypur dhe të njëjtat janë shpërndarë institucioneve të ndryshme të AAP-së dhe institucioneve tjera që ndërlidhen me fushën e AAP, si dhe palëve me interes në këtë fushë, përfshirë edhe institucionet partnere jashtë vendit.



Material promovues rreth sigurimit të cilësisë

Mirëmbajtja dhe përditësimi i uebfaqes

Uebfaqja e AKK-së e mirëmbajtur nga sektori i IT përmban informata lidhur me organizimin e brendshëm, bazën ligjore, vendimet e KD, udhëzues dhe dokumente të nevojshme për implementimin e KKK, informata të ndryshme rreth proceseve të standardeve të profesionit, validimit të kualifikimeve dhe akreditimit të institucioneve, zbatim të NjMP dhe monitorim pas akreditimit, të cilat janë me interes për publikun dhe në funksion të transparencës.

Uebfaqja, gjithashtu përmban të gjitha materialet tjera të publikuara nga AKK, në mënyrë që t'ju ofrohen të gjitha palëve të interesuara, në format elektronik. Në të janë publikuar edhe lista e standardeve të profesionit që janë në proces dhe ato të aprovuara, lista me kualifikimet e aprovuara dhe institucioneve të akredituara si dhe institucionet e akredituara për zbatim të NjMP. Uebfaqja është pasuruar me linqe dhe vegëza të reja që ofrojnë mundësi më të mirë kërkimi, si dhe ndërlidhje shtesë me uebfaqet përkatëse.

Në uebfaqen e AKK janë vendosur edhe video dhe materialet tjera që janë përdorur në fushata të ndryshme mediale për të siguruar qëndrueshmëri të vazhdueshme të mesazheve të promovuara.

Për të ndihmuar vetëdijesimin e publikut të gjerë, AKK ka publikuar edhe informata të rëndësishme nëpërmjet plaftormave tjera si dhe rrjete sociale.
AKK ka marrë pjesë po ashtu edhe në numër të konsiderueshëm të tryezave të përbashkëta, në të cilat është diskutuar roli i AKK-së, funksioni dhe objektivat e KKK-së, mekanizmat e zhvilluara nga KKK-ja për zbatimin e saj, si dhe përfitimet e individit nga zbatimi I KKK-së.

Mbështetja dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

AKK në vitin 2022, ka vazhduar frymën e bashkëpunimit me institucione dhe organizata të ndryshme. Në nivel vendi, AKK ka vazhduar bashkëpunimin me institucionet qeveritare, nisur nga ZKM, MASHTI, ministritë dhe agjencitë relavante, Këshillat profesionale, partnerët social, grupet e interesit, qytetarët, etj.

AKK në veçanti i ka kushtuar rëndësi bashkëpunimit dhe mbështetjes ndërkombëtare me institucione, organizata, rrjete, projekte si: Komisioni Evropian, Fondacioni Evropian i Trajnimeve (ETF), Grupin Këshillues të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (KEK), Agjencioni Austriak për Zhvillim (ADA), Lux Development, GiZ, Dvv International, EQAVET, ERI SEE, etj.



Takim pune për regjistrin e kualifikimeve të KKK

AKK gjatë vitit 2022, organizoi sesione trajnimesh për zbatimin e NjMP me mbështetjen nga DVV International. AKK, përmes këtij projekti kishte për qëllim mbështetjen e organizatave jo-qeveritare potenciale për të zbatuar NjMP, konkretisht rreth informimit dhe ngritjes së kapaciteteve për komponentën e Njohjes së Mësimit Paraprak në Kosovë. Aktivitetet e projektit ishin: Identifikimi i grupeve të synuara dhe përfituesit për zbatimin e NjMP, informimi për zbatimin e NjMP, sfidat, benefitet si dhe procesi i akreditimit si dhe ngritja e kapaciteteve të ofruesve dhe të AKK për NjMP.

Për të përmbushur synimin e këtij projekti, AKK realizoi:

- Hulumtimi me qëllim të identifikimit të nevojave të OJQ që merren me arsim dhe aftësim për të rritur në Kosovë si dhe mundësinë e tyre për zbatimin e Njohjes së Mësimit Paraprak;

- Trajnimi i stafit për zbatimin e NjMP për organizatat e interesuara si dhe
- Trajnimi për zhvillimin e mekanizmave të brendshme për zbatimin e NjMP dhe përgatitja për procesin e akreditimit.

Projekti KSV/801 "Përkrahja e Bashkimit Evropian (BE) për Arsim dhe Aftësim Profesional (AAP)" ESVETPRO i financuar nga Bashkimi Evropian i cili implementohet nga Agjencia e Luksemburgut përBashkëpunim për Zhvillim-LuxDev, përpos tjerash përmban në vete komponentën e NjMP për të cilën është përfitues AKK. Një nga qëllimet kryesore të projektit është fuqizimi i komponentës së Njohjes së mësimit paraprak (NjMP) në nivel të Kosovës dhe ta bëjë më funksional në sektorët/profesionet më të nevojshme ekonomike si një formë e rritjes së punësimit dhe mundësive të mësimit gjatë gjithë jetës.

Gjatë vitit 2022, në mbështetjen e këtij projekti është lansuar platforma digjitale për NjMP ku përmes kësaj platforme përveç informatave dhe dokumenteve për komponentën e NjMP do të krijohet mundësia për regjistrimin e kandidatëve në këtë platform. Kandidatët e interesuar do të shprehin interesin e tyre për kualifikimet përkatëse, ku me këtë rast kandidatëve do t'u krijohet mundësia për të aplikuar për NjMP në institucionet e akredituara. Po ashtu, gjatë këtij viti është lansuar edhe platforma e E-akreditimit për procesin e akreditimit për zbatimin e NjMP.

Me mbështetjen e këtij projekti, AKK dhe instituti Ed Guard kanë zhvilluar aktivitetet lidhur me ngritjen e kapaciteteve të ofruesve për zbatimin e NjMP; ngritjen e kapaciteteve te vleresuesve të jashtëm si dhe u organizua trajnimi për trajner të trajnerëve të praktikuesve të NjMP. Në këto trajnime u prezantuan politikat e NjMP, baza ligjore, procedurat dhe kriteret për procesin e akreditimit si dhe u prezantua roli i stafit kompetent për zbatimin e NjMP në institucionet potenciale që do të mund të aplikojnë me mbështetjen e projektit ESVET PRO. Kandidatët e certifikuar janë caktuar pjesë e listës së ekspertëve të AKK për vlerësimin e institucioneve potenciale për zbatimin e NjMP.



Lansimi i platformës së E-akreditimit për procesin e akreditimit për zbatimin e NjMP

Ndërsa në nivelin ndërkombëtar, përfaqësuesit e AKK morën pjesë në takimet e rregullta të Grupit Këshillues i Kornizës Evropiane të Kualifikimeve. Në këto takime u diskutuan dhe u pasqyruan raporte mbi zhvillimet kombëtare rreth KEK, zhvillimet rreth projektit "Krahasimi Horizontal", përditësimet dhe prezantimi i rezultateve të anketës së KKK nga Cedefop, etj. Në këto takime u paraqiten edhe raportet e përditësuara të referencimit nga shtetet: Franca dhe Italia si dhe zhvillimet dhe aktivitetet lidhur mevalidimin e të mësuarit joformal dhe joformal si mekanizmat për zhvillimin e metodologjive cilësore të validimit.

Në takimet e rregullta të Grupit Këshillues i Kornizës Evropian u paraqiten dhe u raportuan edhe mbi zhvillimet kombëtare në zbatimin e KEK si dhe zhvillimet përkatëse për bashkëpunim evropian në arsim, aftësim dhe punësim nga Komisioni Europian, shtetet anetare, etj.

Po ashtu rëndësi të veqantë i kushtuan edhe temave në lidhje me validimin e mësimit joformal dhe informal, kualifikimet dhe mundësitë e të mësuarit ndërlidhur me transformimin dixhital me specifikat mbi Kredencialet dixhitale evropiane për mësim: gjendja reale dhe hapat të mëtejshëm si dhe sigurimi i informacionit mbi kualifikimet dhe mundësitë e trajnimit ndërlidhura në Europass.

Përfaqësuesit e AKK morën pjesë në takim pune (aktivitet i përbashkët) rreth kualifikimeve ndërkombëtare i cili u organizua nga Grupi Këshillues i Kornizës Evropiane të Kualifikimeve dhe u mbajt në Bruksel, Belgjikë. Qëllimi i përgjithshëm i këtij aktviteti ishte të diskutohej dhe të bëhej shkëmbimi i informacionit dhe i procedurave për kualifikimet ndërkombëtare në Kornizat Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) dhe përfundimisht të bihet dakord për një procedurë të përbashkët në nivel europian. Si rezultat i këtij takimi u bë dakrodimi fillestar rreth procedurave për vendosjen e kualifikimeve ndërkombëtare në KKK sipas procedurës të unifikuar në nivel të BE.

Në vazhdën e takimeve në lidhje me KKK dhe qasjen europiane, AKK ishte pjese e aktivitetit të përbashkët rreth "Strategjisë, instrumenteve dhe benefiteve të KEK dhe KKK u organizua nga Grupi Këshillues i Kornizës Evropiane të Kualifikimeve/Komisioni Europian dhe Ministria e Arsimit në Holandë, e cila u mbajt në Hagës, Holandë. Tema kryesore e diskutuar në këtë takim ishte se si akteret e përfshirë në zbatimin e KKK të i'u qasen dhe afrohen palëve të ndryshme të interesit dhe përdoruesve përfundimtarë (përfituesve) të KEK-së dhe KKK-ve, si dhe si t'iu komunikohen atyre për përfitimet dhe përdorimin e KEK/KKK.

AKK poashtu mori pjesë në Forumin e ETF për sigurim të cilësisë në AAP, ku në fokus kishte masat e sigurimit të cilësisë në lidhje me metodologjinë për vlerësimin e jashtëm në shkollat e AAP-së. Vizita u organizua nga institucioni anëtar i Forumit për Malin e Zi, Qendra për Arsim dhe Aftësim Profesional të Malit të Zi dhe Ministria e Arsimit e Malit të Zi ku paraqitën metodologjinë e tyre për vlerësimin e jashtëm në shkollat e AAP-së dhe njëkohësisht morën informatë kthyese nga kolegët e Forumit të Sigurimit të Cilësisë.

AKK se bashku me MASHTI janë pjesë projektit "Rritja e cilësisë së arsimit dhe trajnimit në Europen Jug Lindore – EQET SEE" i implementuar nga Iniciativa e Reformës Arsimore e Evropës Juglindore/ Education Reform Initiative of South Eastern Europe - ERI SEE me fokus komponentën e sigurimit të cilësisë së jashtëm.

Projekti "EQET SEE" synon të kontribuojë në reduktimin e papunësisë së të rinjve në Evropën Juglindore duke mbështetur zhvillimin e arsimit të orientuar nga tregu i punës, gjithëpërfshirjes sociale si dhe në ngritjen e cilësisë së arsimit në vendet si Shqipëria, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Moldavia, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbisë. Projekti zbatohet në bashkëpunim me partnerët strategjik, ministritë e arsimit, OeAD dhe Konferencën e Përhershme Ndërkombëtare të Inspektorateve (SICI), partnerët lokalë, Fondacionin Evropian të Trajnimit (ETF) dhe ËB6 CIF. Në nivel kombëtar, projekti zbatohet nga agjencitë/departamentet e AAP, Odat ekonomike dhe agjencitë e sigurimit të cilësisë (SC) në arsimin para-universitar.

Nën organizimin e sekretariatit të ERI SEE, së bashku me përfaqësuesit dhe partnerët strategjik të projektit, Fondacionin Evropian të Trajnimit (ETF), përfaqësues nga vendet anëtare të projektit, si dhe ekspert ndërkombëtarë për sigurimin e cilësisë, menaxhimin e të dhënave dhe fushave tjera, përfaqësuesit e AKK dhe MASHTI morren pjese në aktivitete të ndryshme të projektit. Në kuadër të këtyre aktiviteteve, MASHTI u përfaqësua nga Departamenti i AAP dhe Inspektoriati i Arsimit të Kosovës.

Fillimisht, në muajin Mars të vitit 2022 në Beograd u mbajt takimi i "Vizionit të Politikave" për të eksploruar rolin e vlerësimit të jashtëm të institucioneve dhe qasjet për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, efikasitetit dhe efektivitetit të proceseve të Sigurimit të Cilësisë (SC), në mënyrë që të arrijnë pozicionet e përbashkëta ose vizionin rajonal mbi aspektet e përbashkëta të vlerësimit të jashtëm të cilësisë.

Më tutje, në prill të këtij viti në Podgoricë, u zhvillua trajnimi për menaxhimin e të dhënave dhe politikëbërjen e bazuar në dëshmi, aktivitet ky i organizuar në kuadër të komponentiës së Sigurimit të Cilësisë të projektit "EQET SEE".

Trajnimi për menaxhimin e të dhënave dhe hartimin e politikave të bazuara në dëshmi u organizua me qëllim të përmirësimit të procesit të mbledhjes, analizës dhe përdorimit të të dhënave në procesin e vlerësimit të jashtëm dhe lehtësimin e shkëmbimit të përvojave ndërmjet politikëbërësve dhe ekspertëve të sigurimit të cilësisë nga vendet e Evropës Juglindore dhe Moldavisë.

Në vazhdimësi, në maj të 2022 në Beçiç të Malit të Zi, u mbajt takimi për zhvillimin e standardit të kompetencave për vlerësuesit e jashtëm. Ky takim u organizua me qëllim të zhvillimit të një standardi rajonal të kompetencave për vlerësuesit e jashtëm.

Takimi i fundit e ketij grupi per vitin 2022, u mbajt në Tiranë për zhvillimin e pyetësorit për analizës e nevojave për trajnimin e vlerësuesëve të jashtëm në kuadër të përmirësimeve në cilësinë e arsimit dhe aftësimit profesional.

Projekti "EQET SEE" financohet nga Agjensioni Austriak për Zhvillim me fondet e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim dhe bashkëfinancuar nga Iniciativa e Reformës Arsimore e Evropës Juglindore (ERI SEE).



Pjesëmarrje e AKK në projektin EQET SEE në Podgoricë



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Adresa: Qendra Studentore Rr. "Agim Ramadani" p.n.
10000, Prishtinë, Republika e Kosovës

https://akkks.rks-gov.net/